



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 536 Prot

Vlorë, më: 16.05 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË PASTRIMIT
PËRGJATË SEZONIT TURISTIK

Data: 29.04.2024 ora 10.00-12.00
Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.119/2014 "Per të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Klevis Kaso- Nënkryetar i Bashkisë Vlorë, Reinolda Lushaj-NSHP, Emiliano Islamaj- Drejtor i Policisë Bashkiake, përfaqësues nga administrata e bashkisë, përfaqësues nga komuniteti dhe media lokale.

Takimin e hapi nënkryetari Bashkisë Vlorë z.Klevis Kaso: Përshendetje dhe ju falenderoj që jeni këtu. Do të fillojmë takimin me banorët e **Rajonit 2**. E dimë sa i rëndësishëm është për biznesin pastërtia. Ne do të propozojmë disa alternativa. Kemi bërë një analizë për pikat problematike gjatë sezonit. Kontenierët e mbetjeve përpara bizneseve janë të tejmbushur në sezon. Qeskat e zeza janë jashtë koshave. E kemi menduar në dy fasha orare. Fasha e parë është 15.00-17.30. Bizneset që prodhojnë shumë mbetje duhet të jenë të fokusuar në këtë orar. Do ketë një mbikqyrje nga komisioni. Fasha e dytë është në orarin 22.00-24.00. te zona e Kombinatit do të vendoset në dispozicion një kamiocinë për bizneset me shumë mbetje në prodhim. Një problem i konstatuar janë edhe mobiljet që i zbresin në kontenierë. Do ndërgjegjësohet komuniteti dhe bizneset me spote ndërgjegjësuese në mënyrë që të depozitohen mbetjet në vendgrumbullim. Në oraret e përcaktuara, nëse kanë emergjenca do të kenë numrin e telefonit të mbikqyrës dhe kamiocinës për most ë grumbulluar mbetje të tepërta pranë bizneseve. NSHP është në sfidë së bashku me me biznesin dhe qytetarët si dhe bashkia, të jemi bashkë dhe gati për

sezonin turistik. Nuk ka bashki me eficencë pa bashkëpunimin e të gjithëve. Keni sygjërim për oraret? Do vendosim nr. e kamiocinave në dispozicion.

Orest Ruci-Administrator Rajonin 2: Të jetë pastrimi gjatë gjithë ditës, deri te Nimfa. Kamiocina të jetë 07.00-10.00 deri te Rapi.

Klevis Kaso: Kemi policinë bashkiake për bashkëpunim. Masat që do merren janë për eficencën e pastërtisë. Janë marrë masa penalizuese me qëllim pastërtinë.

Arjana Breshani: faleminderit. Duhet fushatë sensibilizuese me banorët, ndarja në burim. Përdorimi i qeskave për mbetje plastike, qeska, është fenomeni që nuk i hedhin në kosha ata që bëjnë ndarje të mbeturinave. Shumë mirë për orate e shtuara.

Klevis Kaso: Ndërgjegjësimi është në fazë tjetër. Sot kemi konsultim me biznesin nëpërmjet mediave do të përcojmë këtë mesazh.

Qytetar: Komisioni është në shërbim të mbetjeve?

Reinolda Lushaj: Jo

Rajoni 3:

Qytetar: Kemi përcaktuar masat dhe venddepozitimin. Policia bashkiake bën punë e vet.

Klevis Kaso: gjobat 10-20 mijë të reja. Policia bashkiake ka evidentuar disa raste të kamiocinave që depozitojnë në vende të papërshtatshme. Kemi shumë raste të tjera me mbetje inerte. Një pjesë që do operojnë me mjete të transportit me nr. e mbikqyrësit në rajon që do marr mbetjet.

Qytetar: Familjarët të paguajnë tarifën për të cuar mbetjet inerte në venddepozitimin.

Klevis Kaso: Duhet ndëshkueshmëria për ata që s'kanë ndërgjegje.

Emiliano Islamaj: Kemi bërë sensibilizim për mos të kaluar në extrem. Janë krijuar grupe NSHP mbi 20 raste. Focus sensibilizimi. VKB ndëshkim bizneset që abuzojnë në masë 20 mijë të reja.

Arjana Breshani: Bashkëpunimi dhe të nxirren mbeturinat në orare dhe vendgrumbullim.

Klevis Kaso: 2 mijë lek të reja për kamiocinën për transport, të merren në konsideratë nga familjarët dhe biznes. Faleminderit.

Rajoni 1 dhe 4.

Klevis Kaso: Do fillojmë. Meqë ka pak pjesëmarrje. Pjesa e strukturës e bashkisë. 2 fasha për të gjithë bizneset, restorantet. Orari drekës, depozitimi, kamiocina në dispozicione.

Fasha 1 është 15.00-17.30

Fasha 2 është 22.00-24.00

Cdo biznes në mbetje, të respektohen. VKB për penalizimin e bizneseve. Hedhja e mbeturinave jashtë koshave. Të orientojmë bizneset që prodhojnë të depozitojmë gjatë orarit të fashave dhe të

palosura në kosha. Do ketë gjoba, monitorim i vazhdueshëm nga policia bashkiake për bizneset që bëjnë shkelje. VKB gjobit 10-20 mijë, të ketë ndryshim dhe rritje. Kamiocinat do marrin mbetjet. Familjarët ti cojnë në vendgrumbullim. Bizneset në sasi të mëdha do kenë nr. e mbikqyrësit të Rajonit për ti hequr me kamiocinë. Është edhe makina teknologjike. Oraret e shpeshta. Edukimi dhe ndërgjegjësimi me strukturat. Ndërveprim me stakeholder grupe interesi për pastërtinë e qytetit. Të respektojnë oraret që mos kalojnë në masat ndëshkuese. Kemi ndonjë mendim ndryshe? Prandaj është konsultim.

Rajoni 1:

Qytetar: Problematikat. Kam 1 pyetje, jo vetëm për masat. Të merren masa në ndërgjegjësim të gjitha strukturat, masa ndëshkuese të jetë më e lartë.

Klevis Kaso: Ndëshkueshmëria patjetër, do parë ligji, por edhe 20 mijë e ka një ndikim. Struktura e pastrimit? Unë i pari. Drejtoria e shërbimit, grupi mbikqyrës, fotografimi dhe monitorimi, qytetarët.

Qytetar: Të bëhet pastrimi nga bizneset dhe fasoneritë, mbetje të diferencuara.

Klevis Kaso: Evidentimi i bizneseve që gjenerojnë mbetje si dhe marrjen e masave administrative për bizneset.

Emiliano Islamaj: Evidentime dhe bashkëpunime dhe mbikqyrësit në dispozicion.

Qytetar: Për të evidentuar dhe pastruar përgjatë lungomarës, nga ndërhyrjet edhe të supermarketeve që i nxjerrin në anë të rrugës. 1. Është e nevojshme që çdo biznes të bëjë ndarjen e mbetjeve nga pjesa organike. 2. Penaliteti do të jetë në biznes kur ndodh apo kur e raportojmë?

Klevis Kaso: Kontenieri I tejmbushur nga biznesi që konstatohet të orientohen, të hidhen Brenda koshit. Fasha orare, mbikqyrësi të vij të marr mbetjet që gjenerohen përtej kapacitetit të koshit. Marketet janë problemi më i madh depozitimi në cdo orë dhe mbetjet e hedhura jashtë koshave.

Qytetar: OJF mjedisore janë pjesë e bashkëpunimit?

Klevis Kaso: Nuk kemi pasur, por është këshillë me vlerë për ta vendos në praktikë. Rajoni 4 ka angazhim për rastet problematike do vazhdohet me disiplinën që është në mungesë. Venddepozitimet e mbetjeve të mos hidhen jashtë koshit. Gjoba s'ka funksion nuk e bën të ndërgjegjësohet. Një strukturë e përshtatshme. Pika e grumbullimit është për mbetje, jo inerte. Kam evidentuar raste të tejmbushjes. Problem kryesor të ketë ndërgjegjësim, disiplinim. Kontenierët e rinj do vijnë në ndihmë. Të vjetrit janë të amortizuar. Ndërgjegjësimi për të nxjerrë jashtë pllaka dhe divan, me 2 mij lekë të vjetra ti cojnë në vendgrumbullim.

Qytetar: mbetjet janë hedhur në Plazhin e Vjetër. Pylli I Sodës pa kosha. E kemi diskutuar. I hedhin njerëzit sepse nuk ka kosha.

Reinolda Lushaj: po marrim nisëm. Ka shumë pushues që frekuentojnë, duhet të kalojë makina ti mbledh.

Qytetar: Do vendosim cadra, të kalojë makina e pastrimit të plazhit.

Klevis Kaso: Ndërgjegjësimi dhe edukimi me porosi të kryetarit të bashkisë me spot, fletëpalosje në cdo biznes për strukturat në dispozicion të bizneseve. Oraret dhe gjobat.

Rajoni 5

Qytetar: I vetmi shqetësim në zonën ku jam, 200 m nga rajoni i Policisë. Ka projekt? Të konceptohet, kur bie shi rrugica mbytet, të sistemohen ujrat e shiut, kanalizimet.

Klevis Kaso: do bëhet rruga mes për mes do shtrohet.

Rajoni 2 dhe 3

Klevis Kaso: Faleminderit për pjesëmarrjen duke ditur kohën e biznesit, bazuar me nevojat dhe dinamikat. Vazhdimi për pastrimin e qytetit kemi bërë analizë për problemet vendgrumbullimet dhe kontenerët që mbushen ose janë sheshit që shkaktojnë kontaminimin, me imazh më jo të mirë për turistët. Kemi propozuar 2 fasha orare subjektet 15.00-17.30 dhe 22.00-24.00 fluksi dhe trafiku është më i lehtë. Të jeni korekt me orarin. Nuk janë definitive. Kur keni tejmbushje kemi nr. e mbikqyrësiy me kamiocinë për mos të ndotur ambientin. Supermarketet të jenë të orientuar sipas orareve, kur kanë shumë mbetje kemi nr. e kamiocines. Mbetjet inerte, mobilie shtëpiake merrni një kamiocinë private rreh 2 mijë. Fotot nga mbikqyrësit tregojnë mbetje inerte shtëpiake, kur koshi është vetëm për mbetje shtëpiake. Kemi konsultim dhe presim një ide për ti ardhur në ndihmë pastrimit të qytetit. Policia bashkiake është së bashku me ne. VKB ka parashikuar masa. Do bëhet ndërgjegjësim dhe informim.

Qytetar: kam biznes dyqan telefonash. Jam me NIPT, sigurime tatime..përpara dyqanit tim në trotuar shesin ambulant pa leje dhe bëjnë evasion fiscal. Kërkoj të drejtat e mija, sikurse paguaj taksat. Më prishet biznesi nga konkurenca e paligjshme, mbetjet që shesin I hedhin aty.

Klevis Kaso; Nuk është për këtë gjë konsultimi edhe pse është me ndjeshmëri të lartë. Do ngrëm grupe pune me policinë bashkiake dhe taksat.

Qytetar: Është subjekt te tregu, dyqan peshku që ndot gjithë lagjen. Duhet bërë pastrimi irrugës nga tregu deri te Aleksii. Mbeturiant e tregut shkaktojnë probleme higjenike.

Klevis Kaso: subjektet e peshkut kontaminojnë shumë. Do ketë masa nëse nuk respektojnë oraret me ndihmë edhe nga strukturat. Fshesa, nuk mka laagje në qytet që nuk fshihet, me dijeninë time. Do e shikojmë.

Qytetar: Marketet kanë mbetje shumë. I kemi porositur punonjësit 1- 2 herë në ditë është shumë mirë. E duam pastërtinë dhe duhet të jemi bashkëpunues.

Klevis Kaso: I mbani në ambientet tauaj sa tju vij orari ose merrni kaiocinen ne telefon të vijnë tjua marrin.

Qytetar: Ky organizim është i mirë. Ka ndryshuar qasja. Sasia e mbetjeve është facultative nga subjektet që prodhojnë. Restorantet prodhojnë 5-fish. Unë kam kartona. Kam 6 njësi dhe 3 I kam aktive dhe paguaj njësoj, nuk hedh mbetje, me marin më shumë lekë. Pagesat aq san a takon. Biznesi me 3 muaj punë është në presion financiar. Duam mirekuptimin tuaj se jemi qytet turistik, duam zhvillim ekonomik edhe bashkisë edhe institucional me qëllim të ecim para.

Klevis Kaso: Paketa fiskale që ndryshoi sivjet, nuk je i vetmi subjekt që ka pakënaqësi, për tarifën e pastrimit, por subjektet duhet të specifikohen të justifikojmë ato 9 muaj të tjerë. Krijon interaktivitet edhe për pastrimin ne duam të respektohen oraret, ju të qasni kërkesat.

Qytetar: 90% jam dakort me ato që u thanë. Unë kam magazinë depozitojmë nuk prodhojmë mbetje. Tarifa jo nga xhirua por nga lloji i biznesit që gjeneron.

Klevis Kaso: Sygjerim për pastrim? Të mos jemi qytet i pistë kur vijnë turistët. Respektoni fashat orare që ti ndihmojmë strukturat e pastrimit.

Qytetar: Kam edhe dicka. Tregu i orizit është si tregu i bagdatit. Aty dhe makinat edhe njerëzit që shesin, pa kushte, jo dinjitoz. Duhet kthyer në symbol të qytetit, te zhvillohet si zonat e tjera.

Qytetar: të shikohen tarifat sipas biznesit. Fasha orare është e mirë.

Faleminderit!

Konceptoi: Albana Naçi



Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik